

Hapet thirrja për dorëzimin e propozim-projekteve për shkrim-lexim mediatik – NEWS – Media Literacy (CREA-CROSS-2025-MEDIALITERACY) për vitin 2025

Është hapur thirrja për dorëzimin e propozime-projekteve për shkrim-lexim mediatik– NEWS – Media Literacy (CREA-CROSS-2025-MEDIALITERACY) për vitin 2025 me afatin e fundit për dorëzimin e propozime-projekteve deri më 6 mars 2025, deri në orën 17:00 (sipas kohës së Evropës Qendrore).

Në peizazhin mediatik digjital që po evoluon me shpejtësi, Komisioni Evropian vazhdon të investojë në krijimin e zgjidhjeve inovative për të përmirësuar aftësitë e shkrim-leximit mediatik të të gjithë qytetarëve evropianë, për të mbështetur bashkëpunimin efektiv ndërkufitar dhe për të kufizuar ndikimin e dëmshëm të dezinformimit.

Thirrja aktuale është publikuar në kuadër të nënprogramit Ndërsektorial të Evropa Kreative. Buxheti i paraparë për këtë thirrje për vitin 2025 është 2.570.000 euro. Bashkimi Evropian financo 70% të buxhetit të përgjithshëm të projektit gjegjësisht granti nuk mund të jetë më i madh se 500 mijë euro për një projekt. Prandaj, aplikantët duhet të bashkëfinancojnë projektet e tyre edhe nga burime të tjera.

Qëllimi

Qëllimi i thirrjes është të mbështesë projekte që promovojnë shkrim-leximin mediatik në mënyrë që qytetarët të zhvillojnë kuptim kritik të mediave, veçanërisht në mjedisin digjital. Theksi vihet në nxitjen e nismave inovative dhe komuniteteve që përshtaten me ndryshimet në mjedisin mediatik.

Në suazat e kësaj thirrje, do të financohen këto projekte:

- krijimi dhe shpërndarja e përmbajtjes multikulturore dhe shumëgjuhësore që përmirëson aftësitë digjitale të qytetarëve dhe rezistencën ndaj keqinformimit;
- zhvillimi i zgjidhjeve inovative të shkrim-leximit mediatik të përshtatura me mjedisin e ardhshëm mediatik;
- trajnime dhe seminare për qytetarët dhe edukatorët, duke përfshirë shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet rajoneve të ndryshme në Evropë;
- organizimi i ngjarjeve publike dhe punëtorive për të rritur ndërgjegjësimin për shkrim-leximin mediatik.

Prioritetet

- Ndarja e praktikave më të mira në fushën e shkrim-leximit mediatik përmes projekteve që kalojnë kufijtë kulturorë, gjuhësorë dhe kombëtarë.
- Zhvillimi i mjeteve interaktive online për të luftuar dezinformimin.
- Krijimi i materialeve dhe mjeteve edukative për qytetarët në mënyrë që të zhvillohet qasje kritike ndaj mediave.
- Zhvillimi i praktikave të shkrim-leximit mediatik të përshtatura ndaj sfidave të reja, duke përfshirë teknikat manipuluese dhe prodhimin mediatik të AI.

Aplikantët e kualifikuar

Aplikantët e kualifikuar për këtë thirrje janë konsorciume të përbëra nga të paktën 3 persona juridikë nga të paktën 3 vende të ndryshme që marrin pjesë në programin Evropa Kreative. Konsorciumet mund të përfshijnë:

- organizatat fitimprurëse dhe jofitimprurëse (private ose publike);
- autoritetet publike (kombëtare, rajonale, lokale);
- organizatat ndërkombëtare;
- universitetet dhe institucionet arsimore;
- organizatat mediatike;
- institucionet kërkimore dhe teknologjike;
- shërbime për shërbime teknologjike.

Rezultatet e pritura

Formimi i konsorciumeve pan-evropiane që do të zhvillojnë praktikatat më të mira përtej kufijve kombëtarë, kulturorë dhe gjuhësorë dhe do të inkurajojnë aktivitetet e edukimit mediatik për të siguruar transferimin e praktikave të tilla tek audiencia më e gjerë, duke mbuluar lloje të ndryshme të mediave.

Organizimi i forumeve për shkëmbimin e praktikave më të mira që angazhohen rreth grupmoshave specifike, grupeve me aftësi ose qasje të kufizuara të shkrim-leximit mediatik, ose atyre në rrezik të përjashtimit social.

Mbështetja e profesionistëve të shkrim-leximit mediatik për të përshtatur praktikatat e tyre me formatet e mediave që evoluojnë me shpejtësi dhe modelet e ndryshimit të konsumit të mediave.

Projektet duhet të sigurojnë përfshirjen aktive të qytetarëve dhe të inkurajojnë kulturë pjesëmarrëse. Rekomandohet gjithashtu bashkëpunimi me Observatorin Evropian të Mediave Digjitale (EDMO) për të shmangur mbivendosijet e nismave dhe për të nxitur shkëmbimin e praktikave të mira..

Kohëzgjatja e projekteve: deri 24 muaj

Mënyra e përgatitjes dhe dorëzimit të propozim-projekteve/aplikimit

Propozim-projektet përgatiten në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në dokumentin e thirrjes: NEWS – Media Literacy (CREA-CROSS-2025-MEDIALITERACY), Version 1.0, 22 October.

Linqet për dokumentet e thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/CREA-CROSS-2025-MEDIALITERACY?order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=relevance&keywords=medialiteracy&isExactMatch=true&status=31094501,31094502>

https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/docs/2021-2027/crea/wp-call/2025/call-fiche_crea-cross-2025-medialiteracy_en.pdf

Aplikacionet përpunohen dhe dorëzohen në mënyrë elektronike nëpërmjet

Funding &Tenders Opportunity Portal (F&TP).

Informacione për qasje në **F&TP** mund të gjeni në:

https://www.eacea.ec.europa.eu/grants/how-get-grant_en

Më shumë informacione rreth thirrjes mund të merrni në sesion online të organizuar nga Komisioni Evropian që do të mbahet më 14 nëntor 2024 nga ora 10:30 deri në orën 14:00.

Për pjesëmarrje në online sesionin mund të paraqiteni në këtë link: [Creative Europe-MEDIA and Cross sectoral 2025](#)